VENDIM
Nr. 408, datë 20.5.2020

PËR MIRATIMIN E ÇMIMEVE TË SHITJES SË TEKSTEVE TË BOTUARA NGA QENDRA E BOTIMEVE PËR DIASPORËN, "KLASIKËT DYGJUHËSH" DHE "FJALOR DYGJUHËSH PËR FËMIJË" DHE TË KATEGORIVE QË PËRFITOJNË FALAS KOPJE TË TEKSTEVE

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të shkronjës "a", të nenit 5, të ligjit nr.16/2018, "Për diasporën", të shkronjës "gj", të nenit 21, të ligjit nr.9616, datë 27.9.2006, "Për librin në Republikën e Shqipërisë", dhe në vijim të pikave 10, shkronja "dh", dhe 19, të vendimit nr.469, datë 26.7.2018, të Këshillit të Ministrave, "Për krijimin, organizimin dhe funksionimin e Qendrës së Botimeve për Diasporën", me propozimin e ministrit të Shtetit për Diasporën, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Miratimin e çmimeve të shitjes së teksteve të botuara nga Qendra e Botimeve për Diasporën, të serisë "Klasikët dygjuhësh" dhe "Fjalor dygjuhësh për fëmijë", sipas listës nr.1, që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij, me qëllim mundësimin e ruajtjes, të zhvillimit dhe të mësimit të gjuhës shqipe e të kulturës shqiptare në diasporë.
2. Kategoritë që i përfitojnë falas tekstet e botuara nga Qendra e Botimeve për Diasporën janë nxënësit dhe mësuesit, sipas përcaktimeve në vendimin nr.443, datë 26.6.2019, të Këshillit të Ministrave, "Për organizimin e procesit mësimor dhe përzgjedhjen e arsimtarëve në diasporë".
3. Seria "Klasikët dygjuhësh" dhe "Fjalor dygjuhësh për fëmijë", të botuara nga Qendra e Botimeve për Diasporën, duhet të jenë të pajisura me logon e këtij institucioni.
4. Çmimet e serisë "Klasikët dygjuhësh" dhe "Fjalor dygjuhësh për fëmijë" vendosen në kopertinat përkatëse, në përputhje me listën nr.1, që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij.
5. Efektet financiare për zbatimin e këtij vendimi, në vlerën prej 2 800 000 (dy milionë e tetëqind mijë) lekësh, përballohen nga buxheti i miratuar për Qendrën e Botimeve për Diasporën, për vitin 2020.
6. Ngarkohet Qendra e Botimeve për Diasporën për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTËR
Edi Rama

Lista nr. 1

1. Çmimin në kopertinë prej 800 lekësh për serinë (kolanën) "Klasikët dygjuhësh".
Seria ka në përbërje 7 libra me nga 2 rrëfenja për secilin titull:
1. E bukura dhe Bisha – Ujku dhe 7 kecat;
2. Hirushja – Pinoku;
3. Libri i xhunglës – 3 derrkucët e vegjël;
4. Rosaku i shëmtuar – Kësulëkuqja;
5. Piter Pani – Bukuroshja e fjetur;
6. Sirena e vogël – Udhëtimet e Guliverit;
7. Ushtari prej plumbi – Borëbardha.

a) Klasikët dygjuhësorë shqip – italisht
b) Klasikët dygjuhësorë shqip – greqisht
c) Klasikët dygjuhësorë shqip – anglisht

d) Klasikët dygjuhësorë shqip – gjermanisht
e) Klasikët dygjuhësorë shqip – frëngjisht
2. Çmimin në kopertinë prej 1500 lekësh për librin "Fjalor dygjuhësh për fëmijë".
- Fjalor dygjuhësh për fëmijë shqip – italisht
- Fjalor dygjuhësh për fëmijë shqip – greqisht
- Fjalor dygjuhësh për fëmijë shqip – anglisht
- Fjalor dygjuhësh për fëmijë shqip – gjermanisht
- Fjalor dygjuhësh për fëmijë shqip – turqisht
- Fjalor dygjuhësh për fëmijë shqip – frëngjisht
- Fjalor dygjuhësh për fëmijë shqip – ukrainisht
- Fjalor dygjuhësh për fëmijë shqip – kroatisht
- Fjalor dygjuhësh për fëmijë shqip – spanjisht